Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 21.2, 61.2, 72 dhe 74 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr. 28, datë 4 qershor 2008),

Me qëllim të rregullimit të sigurisë së aerodromeve në dispozicion për shfrytëzim publik civil dhe të përcaktimit të kushteve për aprovim, operim dhe mirëmbajtje të aerodromeve të tilla,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të palëve të interesuara, konform Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 3/2012
MBI AERODROMET E APROVUARA

Neni 1
Fushëveprimi

Kjo Rregullore vlen për aerodromet e pa certifikuara, në dispozicion për shfrytëzim publik civil.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Rregulloreje përkufizimet që janë përdorur në këtë Rregullore kanë kuptimet vijuese:

"Aerodrom" **-** nënkupton një zonë të caktuar mbi tokë (duke përfshirë çfarëdo ndërtesash, instalimesh dhe pajisjesh) e cila synon të përdoret plotësisht apo pjesërisht për arritje , nisje dhe lëvizje të mjeteve ajrore. Në këtë Rregullore termi "aerodrom" përfshin heliportet, fushat ajrore dhe/ose fushat e planerimit.

"Aprovimi i aerodromit" nënkupton një aprovim të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës sipas kësaj Rregulloreje për operim të aerodromit.

"Objektet dhe pajisjet e aerodromit" nënkupton objektet dhe pajisjet brenda apo jashtë kufijve të aerodromit që janë të ndërtuara apo instaluara dhe që mirëmbahen për arritje , nisje dhe lëvizje të mjeteve ajrore .

"Operatori i aerodromit" **-** në lidhje me aerodromin e aprovuar, nënkupton poseduesin e Aprovimit të Aerodromit.

"Aneksi 14" nënkupton Aneksin 14 Vëllimi 1 "Aerodromet" dhe Vëllimi 2 "Heliportet", i Konventës së Çikagos.

"Aneksi 13" nënkupton Aneksin për "Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve të Mjeteve Ajrore" i Konventës së Çikagos.

"Aerodrom i aprovuar" nënkupton një aerodrom operatori i të cilit posedon aprovimin e aerodromit.

"AAC" nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës.

"Konventa e Çikagos"- nënkupton bazën ndërkombëtare për marrëveshjet e aviacionit civil, e cila zyrtarisht njihet si Konventa e Aviacionit Civil Ndërkombëtar për themelimin e ICAO-s (Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil).

"Operator me bazë fikse" nënkupton ndonjë person, kompani apo korporatë, me bazë fikse në aerodrom, i cili kryen funksione të aviacionit apo ofron shërbime në lidhje me aviacionin.

"Heliport" nënkupton një aerodrom apo një zonë të caktuar në ndonjë strukturë që ka për qëllim të shfrytëzohet plotësisht apo pjesërisht për arritje , nisje dhe lëvizje të helikopterëve ."

"Pengesë" në lidhje me aerodromin, nënkupton të gjitha objektet fikse dhe të lëvizshme (qoftë të përkohshme apo të përhershme), apo pjesët e tyre, që janë të vendosura në një zonë të caktuar për lëvizje të mjeteve ajrore apo që shtrihen përtej zonës së definuar e cila ka për qëllim mbrojtjen e mjeteve ajrore gjatë fluturimit.

KAPITULLI 1
Aprovimi i aerodromit

Neni 3
Standardet e miratimit

Çdo referencë në standarde është referencë Standardeve të aerodromit të parapara në Aneksin 14 të ICAO-s, në këtë Rregullore dhe çfarëdo standarde tjera të parapara nga AAC.

Neni 4
Kushti për aprovimin e aerodromit

Operatori i aerodromit në shfrytëzim për operimet publike civile duhet të ketë në posedim një aprovim të lëshuar nga AAC, pas plotësimit të standardeve të përshkruara në këtë Rregullore.

Neni 5
Aplikimi për aprovimin e aerodromit

5.1 Aplikuesi mund të aplikoj tek AAC për një aprovim të aerodromit që autorizon aplikuesin të drejtoj një aerodrom në vendin e cekur në aplikacion.

5.2 Aplikacioni duhet të jetë në një formë të aprovuar dhe duhet të përfshijë procedurat e operimeve dhe të mirëmbajtjes së aerodromit nga operatori, planin e aerodromit dhe dëshminë e pagesës së tarifës së paraparë nga AAC.

Neni 6
Dhënia e aprovimit të aerodromit

6.1 Në mbështetje të dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, AAC mund të aprovoj aplikacionin dhe aplikuesit t'i jap aprovimin e aerodromit.

6.2 Para se të jap një aprovim të aerodromit, AAC duhet të sigurohet që:

a) Objektet, shërbimet dhe pajisjet e aerodromit janë në përputhje me standardet e Aneksit 14, këtë Rregullore dhe me çfarëdo standardi tjetër të paraparë nga AAC;
b) Procedurat për operim dhe mirëmbajtje të aerodromit ofrojnë dispozita të pranueshme për sigurinë e mjetit ajror;
c) Aplikuesi do të jetë në gjendje të operojë dhe të mirëmbajë aerodromin në mënyrë të duhur.

Neni 7
Refuzimi i dhënies së aprovimit të aerodromit

Nëse AAC refuzon të jap aprovimin e aerodromit, AAC duhet që aplikuesit t'i lëshojë një vendim për refuzimin dhe arsyet në lidhje me refuzimin, në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 8
Miratimi i kushteve

8.1 AAC mund të lëshojë aprovim të kushtëzuar i cili i nënshtrohet cilitdo kusht që është i domosdoshëm në interes të sigurisë.

8.2 AAC duhet të justifikojë arsyet e çfarëdo aprovimi të dhënë me kusht.

Neni 9
Kohëzgjatja e aprovimit të aerodromit

9.1 Aprovimi i aerodromit mbetet në fuqi pesë (5) vjet nga data e dhënies.

9.2 Poseduesi i aprovimit të aerodromit duhet të paguajë tarifat për mbajtjen e aprovimit të cilat janë paraparë nga AAC-ja.

Neni 10
Kthimi i aprovimit të aerodromit

10.1 Poseduesi i aprovimit të aerodromit duhet t'i ofrojë AAC-së njoftim me shkrim jo më pak se 60 ditë para datës në të cilën aprovimi do të kthehet, në mënyrë që të ndërmerren masat e nevojshme për njoftim.

10.2 AAC do të anulojë aprovimin në datën e përcaktuar në njoftim.

Neni 11
Anulimi apo suspendimi i aprovimit të aerodromit

11.1 AAC mund të suspendojë apo të anulojë një aprovim aerodromi, nëse ka arsye të bazuar për të besuar se:

a) Kushti, me të cilin është kushtëzuar aprovimi, është shkelur; apo
b) Objektet, pajisjet operimet apo mirëmbajtja e aerodromit nuk janë në përputhshmëri me standarde të kërkuara në interes të sigurisë së operimeve ajrore.

11.2 Para se të suspendohet apo të anulohet një aprovim aerodromi, AAC duhet t'i ofroj poseduesit një njoftim ku parashtron faktet dhe rrethanat të cilat arsyetojnë suspendimin apo anulimin dhe fton poseduesin e aprovimit të ofrojë me shkrim dhe brenda një kohe të arsyeshme informata përkitazi me nivelin e shkeljes së sigurisë, dhe masat parandaluese të ndërmarra.

11.3 AAC do të merr parasysh arsyet që ofron poseduesi brenda kohës së përshkruar në njoftimin me shkrim, përkitazi me nivelin e shkeljes së sigurisë, para se të merr vendim mbi suspendimin apo anulimin e aprovimit.

11.4 Njoftimi për suspendim apo anulim do të hyjë në fuqi në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 12
Transferimi i aprovimit të aerodromit

12.1 AAC mund të jep pëlqim dhe të lëshojë një instrument transferimi të aprovimit të aerodromit një pranuesi të transferit kur:

a) Poseduesi aktual i aprovimit të aerodromit e njofton AAC-në me shkrim së paku 60 ditë para se të pushon së drejtuari një aerodrom, se do të pushojë së operuari aerodromin që nga data e specifikuar në njoftimin me shkrim;
b) Poseduesi aktual i aprovimit të aerodromit i komunikon AAC-së me shkrim emrin e pranuesit të transferit;
c) Pranuesi i transferit aplikon me shkrim tek AAC brenda 45 ditëve para se poseduesi aktual i aprovimit të aerodromit të pushojë së drejtuari aerodromin, në mënyrë që aprovimi i aerodromit të transferohet tek pranuesi i transferit; dhe
d) Kushtet e nenit 6.2 të jenë plotësuar.

12.2 Nëse AAC nuk miraton transferimin e aprovimit të aerodromit, AAC duhet të lëshojë aplikuesit një vendim për refuzimin dhe arsyet për refuzimin, në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 13
Ndryshimi i aprovimit të aerodromit

Me kusht që kushtet e nenit 6.2, 14 dhe 15 të jenë plotësuar, AAC, mund të ndryshojë një aprovim të aerodromit kur:

a) Ka ndryshim në operatorin e aerodromit;
b) Ka ndryshim në përdorimin apo drejtimin e aerodromit;
c) Ka ndryshim në kufijtë e aerodromit;
d) Poseduesi i aprovimit të aerodromit kërkon ndryshim.

KAPITULLI 2
Procedurat

Neni 14
Procedurat e operimit dhe të mirëmbajtjes

14.1 Operatori i aerodromit duhet të hartojë dhe zbatojë procedurat e nevojshme për drejtimin dhe mirëmbajtjen e aerodromit për operime të sigurta të fluturimit.

14.2 Operatori i aerodromit duhet t'i ofrojë AAC-së një kopje të kompletuar dhe aktuale të procedurave të operimit dhe të mirëmbajtjes së aerodromit.

Neni 15
Njoftimi për ndryshimet

Operatori i aerodromit duhet ta njoftojë AAC-në sa më shpejtë të jetë e mundur rreth çfarëdo ndryshimi që operatori synon t'u bëjë procedurave.

KAPITULLI 3
Karakteristikat fizike

Neni 16
Heliportet e aprovuara

Karakteristikat fizike të heliporteve të aprovuara duhet të jenë në përputhshmëri me standardet e parapara në Aneksin 14, të ICAO-s, Vëllimi II, "Heliportet".

Neni 17
Aerodromet e aprovuara me pista të shtruara

17.1 Ky nen vlen për aerodromet e aprovuara me pista të shtruara duke përjashtuar heliportet e aprovuara.

17.2 Karakteristikat fizike minimale të kërkuara për aerodromet e aprovuara me pista të shtruara duhet të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara me Kodin referent të Aerodromit 1A, ICAO Aneksi 14 Vëllimi 1, "Aerodromet".

Neni 18
Aerodromet e aprovuara me pista të pa shtruara

18.1 Ky nen vlen për aerodromet e aprovuara me pista të pa shtruara duke përjashtuar heliportet e aprovuara.

18.2 Gjatësia e pistës duhet të jetë e mjaftueshme për llojin e mjetit ajror i cili operon në aerodrom.

18.3 Gjerësia e pistës nuk mund të jetë më pak se 30 metra.

18.4 Gjerësia e brezit të pistës nuk mund të jetë më pak se 60 metra. Gjatësia e brezit duhet të zgjatet para fillimit gjegjësisht pragut dhe përtej fundit të pistës në një distancë prej së paku 30 m.

18.5 Sipërfaqja e pistës duhet të mbahet sa më e rrafshët dhe e drenuar. Sipërfaqet e forta duhet të inspektohen rregullisht dhe të pastrohen nga mbeturinat. Sipërfaqet me bari duhet të kositen dhe ngjeshen me cilindër. Bari duhet të mbahet në lartësi prej maksimum 10 cm.

18.6 Pista duhet të dizajnohet ashtu që drunjtë, shtyllat elektrike, toka e ngritur apo pengesat tjera nuk pengojnë shtigjet e afrimit dhe ngritjes së mjetit ajror. Nuk lejohen pengesat më të larta se 45 m mbi kuotën mesatare të pistës brenda 2,000 m nga pika e mesme e pistës.

18.7 Pjerrtësitë gjatësore dhe tërthore të pistës kufizohen në maksimum 3%.

18.8 Pista në aerodrom që përdoret për një ngjarje – p.sh. një takim gare – dhe/apo ku priten shumë vizitorë, duhet të pozicionohet në aso mënyre që të shmanget fluturimi mbi spektatorët e mbledhur, parkingjet e veturave apo zonave tjera që kanë të ngjarë të tërheqin numër të madh të njerëzve.

18.9 Pista duhet të orientohet për të shmangur fluturimin mbi popullatën, shtëpitë, stallat, dhe vende tjera të ndjeshme gjatë ngritjes dhe afrimit për aterrim.

18.10 Fortësia dhe aftësia mbajtëse e pistës duhet të ndërtohet ashtu që t'i bëjë ballë peshës së mjetit ajror që do të përdoret në aerodrom.

18.11 Skajet dhe fundi i pistës duhet të kufizohen me shenja drejtkëndëshe me ngjyrë të bardhë apo me tabela shenjëzimi, rrafsh me sipërfaqen e pistës, secila nga 3 m e gjatë dhe 1 metër e gjerë, në intervale jo më shumë se 90 m. Si alternativë, mund të përdoren markerët e ngritur, lehtë të thyeshëm (siç janë konet e trafikut) në të njëjtën distancë.

Neni 19
Treguesi i erës

19.1 Duhet të vendoset treguesi i erës, qartë i dukshëm nga ajri dhe i pozicionuar ashtu që të tregojë drejtimin dhe shpejtësinë e erës.

19.2 Operatori i aerodromit duhet t'iu shmanget lokacioneve afër drunjëve apo ndërtesave apo aty ku terreni mund të ofrojë një indikacion jo te saktë. Duhet të sigurohet që treguesi i erës të mos u pengojë mjeteve ajrore gjatë operimeve dhe të jetë i vendosur së paku 50 m larg çfarëdo pengese tjetër.

Neni 20

Pengesat

20.1 Sipërfaqet për kufizim të pengesave duhet të vendosen ashtu siç parashihet në Aneksin 14 të ICAO-s.

20.2 Çdo gjë që, për shkak të lartësisë apo pozitës së tyre (antenë për radio dhe televizion, oxhaqe, kabllo të transmisionit të energjisë elektrike, drunj, etj.) mund të paraqet rrezik për mjetin ajror gjatë operimeve duhet të shënjohet qartë sipas Rregullores nr. 2/2010 mbi Shënjimin e pengesave, nëse nuk mund të largohen apo të zvogëlohen.

20.3 Lartësia e pengesës më të lartë përbrenda 6 km nga qendra e aerodromit, së bashku me ndonjë pengesë tjetër potencialisht te rrezikshme jashtë kufirit të aerodromit, mbi të cilin operatori i aerodromit nuk mund të ushtrojë kontroll, duhet të përmendet në secilin publikim të informatave aeronautike në të cilin bën pjesë aerodromi.

20.4 Lokacioni i rrugëve, ndërtesave dhe i ndonjë strukture tjetër jashtë perimetrit të aerodromit duhet të merret parasysh kur të projektohen drejtimet e pistave për të lejuar arritjen nisjen dhe operime të sigurta pa i rrezikuar njerëzit apo automjetet që përdorin rrugët, ndërtesat dhe ndonjë strukturë tjetër.

Neni 21
Ndriçimi i aerodromit

21.1 Në aerodromet që përdoren natën për operime, duhet të instalohen ndriçime aeronautike të tokës ashtu siç i parasheh Aneksi 14 i ICAO-s.

21.2 Pengesat duhet të ndriçohen, ashtu siç parashihet në Rregulloren nr. 2/2010 mbi Shënjimin e pengesave.

Neni 22
Shërbimi i shpëtimit dhe zjarrfikjes dhe shërbimet emergjente

Ofrimi i shërbimit të shpëtimit dhe zjarrfikjes dhe shërbimet emergjente duhet të bëhen sipas kërkesave të Aneksit 14 të ICAO-s.

KAPITULLI 4
Obligimet e operatorit të aerodromit

Neni 23
Respektimi i standardeve

23.1 Operatori i aerodromit duhet të respektojë standardet e saktësuara në nenin 3 dhe të gjitha kushtet e miratuara në aprovim sipas nenit 8.1 dhe 32.1 të kësaj Rregulloreje.

23.2 Operatori i aerodromit të aprovuar duhet të sigurojë se operimet dhe mirëmbajtja e aerodromit po kryhen për të ofruar sigurinë e operimeve të fluturimit.

23.3 Operatori i aerodromit të aprovuar duhet t'i bëjë të ditur emrat dhe statusin e stafit të lartë drejtues të aerodromit dhe udhëzimet përkitazi me urdhrin dhe rrethanat në të cilat ata duhet të veprojnë

Neni 24
Kompetencat e personelit operativ dhe të mirëmbajtjes

24.1 Operatori i aerodromit duhet të punësojë një numër adekuat të personelit të kualifikuar dhe të shkathtë për kryerjen e të gjitha aktiviteteve të domosdoshme në proceset e operimit dhe mirëmbajtjes së aerodromit.

24.2 Në rastet kur AAC apo ndonjë autoritet tjetër kompetent i qeverisë, ka paraparë kushtet për certifikim të kompetencës së personelit sipas paragrafit paraprak, operatori i aerodromit duhet të punësojë vetëm ata persona që janë në posedim të certifikatave dhe kualifikimeve të tilla.

Neni 25
Operimi dhe mirëmbajtja e aerodromit

25.1 Varësisht prej ndonjë udhëzimi të cilin mund ta lëshoj AAC-ja, operatori i aerodromit duhet të operojë dhe mirëmbajë aerodromin në përputhje me procedurat e tij.

25.2 Në mënyrë që të garantohet siguria e operimeve dhe mjetit ajror, AAC mund t'i jap udhëzime me shkrim operatorit të aerodromit për ndryshimin e procedurave.

25.3 Operatori i aerodromit duhet të sigurojë mirëmbajtje të duhur dhe efikase për objektet dhe pajisjet e aerodromit.

Neni 26
Qasja në aerodrom

26.1 Personeli i autorizuar nga AAC mund të inspektojë dhe të kryejë teste në objekte, shërbime dhe pajisje të aerodromit, të inspektojë dokumentacionin dhe regjistrat e operatorit të aerodromit dhe të verifikojë aktivitetet e operimeve dhe të mirëmbajtjes para se të jepet apo ripërtërihet aprovimi për aerodromin, dhe më pas,

në çfarëdo kohe tjetër, për qëllime të garantimit të sigurisë së operimeve në aerodrom.

26.2 Operatori i aerodromit duhet, sipas kërkesës së personelit të autorizuar nga paragrafi paraprak, të lejojë qasje në secilën pjesë të aerodromit, apo në secilin objekt të aerodromit, dukë përfshirë pajisjet, shënimet, dokumentacionin dhe personelin e operatorit.

26.3 Operatori i aerodromit duhet të bashkëpunojë në kryerjen e aktiviteteve sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 27
Njoftimi dhe raportimi

27.1 Operatori i aerodromit duhet t'iu përmbahet obligimeve për njoftim dhe raportim AAC-së, kontrollit të trafikut ajror dhe pilotëve brenda afateve kohore të përcaktuara, ashtu siç kërkohet me këtë Rregullore.

27.2 Operatori i aerodromit duhet të rishikojë botimin e Publikimit të Informatave Aeronautike (AIP), Plotësimeve të AIP, Ndryshimeve të AIP, Njoftimeve për pilot (NOTAMS), Buletineve të informatave për fluturime dhe Qarkoreve të Informatave Aeronautike, të lëshuara nga Shërbimi për Informata Aeronautike (AIS) pas pranimit të tyre, dhe menjëherë pas shqyrtimit të tillë të njoftojë AIS-in rreth ndonjë informate ta pasaktë të dhënë në të përkitazi me aerodromin.

27.3 Operatori i aerodromit duhet të njoftojë AAC-në paraprakisht rreth çfarëdo zhvillimi apo para çfarëdo ndryshimi në karakteristikat fizike të aerodromeve të aprovuara, duke përfshirë ndërtimin e ndërtesave të reja dhe ndryshimet në ndërtesat ekzistuese apo në pajisjet vizuale.

27.4 Operatori i aerodromit duhet të njoftojë AIS-in dhe AAC-në me shkrim së paku 60 ditë para çfarëdo ndryshimi në objekte apo në pajisjet e aerodromit ose në nivelin e shërbimit në aerodrom që është planifikuar paraprakisht dhe që ka të ngjarë se prek saktësinë e informatave që i përmbanë secili publikim i AIS-it, sipas paragrafit 2 të këtij neni.

27.5 Varësisht nga nga kërkesat e paragrafit 4 të këtij neni, operatori i aerodromit duhet t'ia jep AIS-it dhe duhet të mundësojë që kontrolli i trafikut ajror dhe njësia e operimeve të fluturimit, të pranojnë njoftim të menjëhershëm me detajet e çfarëdo rrethane në vijim, e për të cilat operatori ka njohuri:

a) Pengesat, bllokimet dhe rreziqet:

   i) Çfarëdo penetrimi nga ndonjë objekt në sipërfaqet për kufizim të pengesave të aerodromit; dhe
   ii) Ekzistimin e çfarëdo pengesë apo gjendje rreziku që prek sigurinë e aviacionit në apo afër aerodromit;

b) Niveli i shërbimit:
   i) Zvogëlimi apo reduktimi në nivelin e shërbimit në aerodrom, i parashkruar në publikimet e AIS-it sipas paragrafit 2 të këtij Neni.
c) Zona e lëvizjes:
   i) Mbyllja e ndonjë pjese të zonës së lëvizjes në aerodrom; dhe
d) Ndonjë gjendje tjetër që mund të prek sigurinë e aviacionit në aerodrom dhe ndaj të cilëve nevojiten të ndërmerren masa paralajmëruese.

27.6 Kur nuk është e mundur që operatori i aerodromit të aranzhojë që kontrolli i trafikut ajror dhe njësia e operimeve të fluturimit të marrin njoftime për ndonjë rrethanë sipas paragrafit 5 të këtij neni, në mënyrë që të veprojë në përputhje me atë paragraf, operatori duhet t'i jep njoftim të menjëhershëm drejtpërsëdrejti pilotit i cili mund të preket nga rrethana e tillë.

Neni 28
Inspektimet e veçanta

Operatori i aerodromit duhet të inspektojë apo aranzhoj inspektim të aerodromit, varësisht prej rrethanave, duke ofruar siguri të aviacionit:

a) Sapo të jetë e mundur, pas një aksidenti apo incidenti të mjetit ajror sipas definicionit të këtyre shprehjeve të cilat definohen me Aneksin 13 dhe Procedurat shtetërore të njoftimit për njoftimin e incidenteve dhe aksidenteve;
b) Gjatë çfarëdo periudhe të ndërtimit apo riparimit të objekteve apo pajisjeve të aerodromit që janë thelbësore për sigurinë e operimeve të mjetit ajror; dhe
c) Në çfarëdo kohe tjetër kur ekziston mundësia në që aerodrom të preket siguria e aviacionit.

Neni 29
Largimi i pengesave nga sipërfaqja e aerodromit

Operatori i aerodromit duhet të largojë ose të aranzhojë largimin e automjeteve apo të pengesave tjera nga sipërfaqja e aerodromit që ka të ngjarë se paraqesin rrezik për operime.

Neni 30
Mbajtja e shënimeve

Poseduesi i aprovimit të aerodromit duhet të krijojë dhe të mbaj shënime mbi trajnimin e personelit dhe inspektimet.

Neni 31
Akomodimi i shërbimeve tjera

Operatori i aerodromit duhet të lehtësojë ushtrimin e funksioneve të autoriteteve tjera përgjegjëse për kontrollimin e kufirit, imigracionit, doganave, shëndetësisë dhe shërbimeve tjera.

Neni 32
Përjashtimet

32.1 AAC mund të lirojë, me shkrim, një operator aerodromi nga respektimi i dispozitave të caktuara të kësaj Rregulloreje në përputhje me Ligjin në fuqi.

32.2 Para marrjes së ndonjë vendimi për lirimin e operatorit të aerodromit, AAC duhet t'i merr parasysh të gjitha rrethanat relevante në interes të sigurisë së operimeve.

32.3 Përjashtimi, varet nga respektimi i kushteve/procedurave nga ana e operatorit të aerodromit të parapara nga AAC në vet aprovimin e aerodromit, si të domosdoshme në interes të sigurisë.

32.4 Në rastet kur aerodromi nuk i plotëson kriteret e standardit të paraparë në nenin 3 të kësaj Rregulloreje, AAC mund të vendos, pas rishikimit të ndonjë studimi aeronautik të kryer nga operatori i aerodromit, vetëm nëse dhe atëherë kur lejohet nga standardet, kushte dhe procedura të ndërlidhura me standarde të cilat janë të nevojshme për të arritur nivelin e sigurisë të barazvlershëm me atë të përcaktuar me standard.

32.5 Shmangia nga standardi dhe kushtet e procedurat sipas nenit 8.1 të kësaj Rregulloreje duhet të parashihen me një miratim në vet aprovimin e aerodromit apo në ndonjë formë tjetër të shkruar. Nëse përjashtimi ofrohet në ndonjë formë tjetër me shkrim, ai duhet të inkorporohet në procedurat e operimeve të aerodromit.

Neni 33
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 10 tetor 2012.

Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm